

UNIVERSITETI “ISA BOLETINI” MITROVICË
FAKULTETI EKONOMIK



PUNIM DIPLOME

Eurona Nura Kalludra

Mitrovicë, 2023

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË
FAKULTETI EKONOMIK



PUNIM DIPLOME

Tema:

Tatimet dhe ndikimi i tyre në NVM-të Kosovare

Mentori:

Prof.Ass.Dr. Qazim Tmava

Kandidati/ja:

Eurona Nura Kalludra

Mitrovicë, 2023

HYRJE.....	5
KAPITULLI I	
KONCEPTET KRYESORE RRETH FINANCAVE PUBLIKE	
1.1 Zhvillimi i teorive rreth Financave Publike.....	6
1.2 Zhvillimi historik i të ardhurave publike.....	9
1.3 Konceptet kryesore rreth tatimeve.....	10
1.4 Llojet kryesore të tatimeve.....	11
1.5 Parimet kryesore rreth tatimeve.....	12
1.6 Konceptet kryesore rreth ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.....	13
KAPITULLI II	
ZHVILLIMI I SISTEMIT TATIMOR NË KOSOVË	
2.1 Definimi i termeve rreth sistemeve tatimore.....	15
2.2 Sistemit tatimore në Kosovë.....	16
2.3 Tatimi në të Ardhurat e Korporatave.....	17
2.4 Tatimi në të Ardhura Personale.....	18
2.5 Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH-ja)	20
KAPITULLI III	
TË HYRAT TATIMORE DHE TRENDI I TYRE PËR PËRIUDHEN 2017-2022	
3.1 Trendi i të hyrave tatimore.....	22
3.2 Të hyrat tatimore sipas regjioneve.....	24
3.3 Trendi i zhvillimit të NVM-ve në Kosovë.....	25
3.4 Indeksi i mjedisit fiskal në Kosovë.....	27
PERFUNDIM DHE REKOMANDIMET	

LISTA E TABELAVE DHE GRAFIKONEVE

Tabela nr. 1. Normat Tatimore mbi të ardhurat personale.....	19
Tabela nr.2. Normat tatimore mbi pagën.....	20
Tabela nr. 3. Të hyrat sipas llojeve të tatimit për periudhën 2017- Qershor 2022.....	22
Tabela 4. Të hyrat tatimore sipas Regjioneve për periudhën 2017- Qershor 2022.....	24
Tabela 5. Tatimet e Papaguara sipas regjioneve.....	24
Tabela nr.6 Numri i shoqërive tregtare të regjistruara sipas formës ligjore.....	25
Tabela nr. 7 Numri i bizneseve që kanë dërguar të dhënat në administratën tatimore.....	25
Tabela nr.8 Të hyrat tatimore nga Bizneset individuale dhe Korporatat.....	26
Grafikoni nr.1 Pjesëmarrja e tatimeve për periudhën 2018-2022.....	23
Grafikoni nr.2 Trendi i të hyrave tatimore për periudhën 2017- Qershor 2022.....	23
Grafikoni nr.3 Trendi i të hyrave nga tatimet në të ardhurat personale dhe korporatave.....	26
Grafikoni nr. 4 Indeksi i mjedisit fiskal.....	27

HYRJE

Përdorimi i politikës fiskale konsiderohet si njeri nga instrumentet më të rëndësishme përmes të cilëve mundësohet krijimi i një ambientit të përshtatshëm për zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme. Përmes përdorimit të politikës fiskale dhe monetare mundësohet ekzistimit dhe funksionalizimi i Shtetit në tersi. Nocioni i financave publike është term i paraqitur që nga koha e themelimit të shtetit, ku në kuptimin më klasik të fjalës në kuadër të nocionit për financat publike përfshihen të hyrat publik të cilat mbliidhen përmes politikave tatimore dhe jo tatimore dhe të hyrave tjera më qëllim të mbulimit të shpenzimeve publike.

Rëndësia e politikës fiskale ndërlidhet direkt me objektivat fundamentale në të cilat bazohet zanafilla e zhvillimit të politikave fiskale të cilat janë: *Objektiva e pare* fundamentale është sigurimi i të mirave materiale dhe shërbimeve publike; *Objektiva e dytë* është rishpërndarja e të ardhurave shoqërore duke synuar zvogëlimin e pabarazive në shoqëri; *Objektiva e tretë* arrihet përmes shfrytëzimit buxhetit me qëllim të stabilizimit të fluktacioneve të cilat shkaktohen në faza të ndryshme të cikleve të biznesit dhe ekonomisë në përgjithësi.

Institucionet Qeveritare duke synuar arritjen e objektivave të cekura më lartë përdorin instrumente të ndryshme të politikës fiskale, ku instrumenti më kryesor konsiderohet politika tatimore e shtetit përmes të cilave sigurohet pjesa më e konsiderueshme e të hyrave buxhetore të cilat shfrytëzohen për përmbushjen e objektivave të politikës fiskale, si dhe prioriteteve të Qeverisë.

KAPITULLI I

KONCEPTET KRYESORE RRETH FINANCAVE PUBLIKE

1.1 Zhvillimi i teorive rreth Financave Publike

Natyra dhe karakteri i financave publike është trajtuar në baze të pikëpamjeve të ndryshme të teorive ekonomike, në aspektin e klasik financat publike përbejnë të ardhurat publike dhe shpenzimet publike, ndërsa në aspektin bashkëkohor koncepti i financave publike përfshin diçka më shumë. Sipas teorisë ekonomike të John M. Keynesi dhe pikëpamjes të teorisë Kenynsiane roli i financave publike është trajtuar vetëm në aspektin politiko-administrativ, ndërsa aspekti ekonomik dhe social nuk ishte i rëndësishëm sipas kësaj pikëpamjes për shkak të doktrinës liberale-kapitaliste, shteti nuk guxon të përzihet në jetën ekonomike por duhet të kufizohet vetëm në ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike (Bexheti, 2007).

Sipas kësaj doktrine në shpenzimet publike konsiderohen vetëm ato shpenzime shtetërore të cilat lidhen direkt me ushtrimin e funksioneve shtetërore të sigurisë, financimin e ushtrisë, policisë, gjyqësorit, si dhe administratës publike. Sipas kësaj teorie në shpenzimet publike nuk duhet të përfshihen shpenzimet publike të realizuar më qellim të zhvillimit të politikave ekonomike, sociale dhe zhvillimore. Sipas pikëpamjes së prezantuar më lart mund të theksojmë se sipas teorisë ekonomike klasike, financat publike janë trajtuar vetëm në aspektin politiko-administrativ. Sipas kësaj teorie roli i financave publike nuk ishte i rëndësishëm për shkak të faktit se sipas doktrinës liberale kapitaliste, shteti nuk duhet të ndërhyjë në jetën ekonomike duke promovuar doktrinën e "*Dorës së Padukshme*"¹, si mekanizmi i cili e rregullon ekonomin e një shtetit pa pasur nevojë përdorimi i instrumenteve shtetërore. Pra roli i shtetit konsiderohej vetëm në ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike.

Pasi bota u përball më krizën e madhe ekonomike të viteve 1929-1933, qëndrimet klasike ekonomike ndryshuan shpejt nën ndikimin e mendimeve të John M Keynesit, ku thekson se janë pikërisht financat publike të cilat e kanë rolin kryesor në nxjerrjen e shoqërisë nga kriza ekonomike. Sot duke analizuar rolin e instrumenteve të financave publike, ju kushtohet rëndësi karakterit dhe ndikimit në ekonomi në aspektin cilësor dhe jo sasior. Duke i kushtuar rëndësi shpenzimeve të cilat i realizon shteti më qellim të zhvillimit të politikave sociale dhe

¹ Koncepti i "dorës së padukshme" u shpik nga mendimtari skocez, Adam Smith (1759). Ajo i referohet forcës së padukshme të tregut që sjell një treg të lirë në ekuilibër me nivelet e ofertës dhe kërkesës nga veprimet e individëve të interesuar.

ekonomike, përmes rishpërndarjes së mjeteve financiare të mbledhura përmes instrumenteve financiare publike, duke realizuar rishpërndarjen e të mirave publike mundësohet përmeshja e nevojave publike. Kuptimi i mënyrës së funksionimit të financave publike ndërlidhet direkt edhe me ideologjinë me të cilën funksionon shteti në përgjithësi, andaj është thelbësore të sqarohet roli të cilën shteti e ushtron përmes mënyrës së si intervenon në ekonomi. Gjatë periudhës Merkantiliste pikëpamja kryesore rreth funksionimit ekonomik të shtetit ndërlidhet direkt me qëndrimin e tyre së pasuria e kombit krijohet duke u fokusuar në tregti e veqenarisht në tregtinë e jashtme. Andaj sipas kësaj pikëpamje qëllimi kryesor i intervenimit të shtetit në ekonomi është rritja e eksportit dhe ulja e importit. Duke përdorur mekanizmat shtetërorë synohet të realizohet mbivlera e eksportit ndaj importit dhe kështu do të mbahen brenda vendit metalet fisnike të cilat përdoren si mjete pagese. Ndërsa fiziokratët konsideronin së pasuria e një kombi varej direkt nga niveli i prodhimit bujqësor dhe së raportet në mese të pjesëmarrësve në jetën ekonomike janë rregulluar me ligje natyrore, të cilat nuk mund të kufizohen me masa të intervenimit shtetëror (Bexheti, 2007).

Gjate trajtimit të zhvillimit të teorive ekonomike është e rëndësishme të trajtohet periudha e fundit të shekullit XVIII deri në fillim të shekullit XX, ku gjate kësaj periudhe u krijuan pikëpamjet e reja në teorinë financiare, të njohura si koncepte bashkëkohore për financat publike. Gjate analizës së teorive klasike ekonomike bazohet në tri pika kryesore: Në lirinë nga intervenimi i shtetit; Idenë për vlerën si formë e punës; Në idenë e mbivlerës si tepriçë e punës. Sipas kësaj teorie intervenimi shtetëror nuk është i nevojshëm në jetën ekonomike, ku në vend të intervenimit shtetëror të hyjë konkurrenca e lirë dhe tregtia e lirë si rregullues natyrore i jetës ekonomike.

Sipas shkollës ekonomike klasike, duke përfaqësuar pikëpamjen për një liberalizim të plotë ekonomik i kundërvihet çdo ndërhyrje të shtetit në jetën ekonomike. Sipas A. Smith ndërhyrja e shteti duhet të kufizohet vetëm në tri funksionet kryesore: 1) *Mbrojtja nga agresioni i jashtëm*; 2) *Krijimin dhe funksionimin e sigurisë së brendshme dhe gjyqësore*; 3) *Sigurimin e mallrave dhe shërbimeve për përfitim publike*. Sipas kësaj pikëpamje shpenzimet publike trajtohen si e keqe pa të cilën nuk mund të bëhet dot, andaj fokusi kryesor duhet të jetë parimi i minimizimit të tyre, vetëm për çështjet elementare të funksionit juridiko-administrativ të shtetit dhe ato të mbrojtjes. Duke u bazuar në teorinë ekonomike klasike, e cila financat publike i trajton si kategori në aspektin politiko-administrativ dhe të

parëndësishëm në pikëpamje sociale ekonomike. Ndërsa nëse analizohen teoritë bashkëkohore financiare theksin kryesor e ka në trajtimin e rishpërndarjes së të mirave publike dhe orientimin e tyre me qëllim të zhvillimit të mirëqenës sociale dhe zhvillimin ekonomik për të gjithë anëtarët e shoqërisë (Smith, 1776). Nëse analizohet struktura e shpenzimeve publike të cilat realizohen sot në ekonomin bashkohore, gjithnjë e më shumë janë në rritje shpenzimet për kategoritë sociale në raport me shpenzimet tradicionale për financim të administratës shtetërore dhe publike të cilat edhe sot janë elemente të rëndësishme për funksionimin e ekonomisë bashkëkohore. Në ekonomin moderne synohet që duke i shfrytëzuar mekanizmat e politikës fiskale të arrihet vendosja dhe të ruhet një baraspeshë ekonomike përmes mekanizmit të rishpërndarjes së resurseve publike (Bexheti, 2007).

Koncepti i ekonomisë moderne, bazën kryesore e ka në teoritë e ekonomisë neoklasike ku roli i ndikimit të shtetit filloj të rritet shumë pas krizës ekonomike botërore të viteve 1929-1933, ku edhe në vendet me ekonomin e tregut me të fuqishme e konstatuan së “*dora e padukshme*”, nuk po arrite të rregullonte dhe të shpërndaj me suksese resurset e për e në veçanti ato të cilat janë më interes publik në shoqëri. Niveli i përdorimit të instrumenteve shtetërore për të ndikuar në ekonomi dallon nga vendi në vend, ku shpesh herë është i varur direkt nga programi politik dhe ekonomik i partive në pushtet por dhe nga gjendja ekonomike e vendeve, është fakt se shtetet mbeten rregulluesi më i rëndësishëm të tregut dhe resurseve në shoqëri. Përdorimi i instrumenteve shtetërore për të intervenuar në ekonomi arsyetohen më “*pamundësinë e tregut*”². Kur analizohen funksionet ekonomike të shtetit synohet të analizohen efektet në rritjen e efikasitetit, barazisë dhe nxitjen e rritjes dhe stabilitetit makroekonomik. Arsyeja pse synohet të argumentohet efekti pozitiv i ndërhyrjes së shtetit në ekonomi, ndërlidhet me qëllimin që kjo ndërhyrje të përmirësoj mangësitë e tregut me qëllim të rritjes së efikasitetit.

Ku procesin e rishpërndarjes së ardhurave publike mundësohet përmes realizimit të shpenzimeve publike. Duke analizuar pikëpamje të ndryshme rreth funksionit të shtetit në ekonomi mund të konstatoj së qëllimi kryesor që secili shtet duhet të këtë parasysh është krijimi i kushteve për një kombinim efektiv në mes të ndërhyrjes së shtetit dhe ndikimit real

² Teorema e Stiglitz-it “*pamundësia e tregut*”, parasheh së dështimi i tregut mund të ekzistojë andaj intervenimi i shtetit mund të përmirësoj shpërndarjen e burimeve brenda tregut, pra instrumentet e shtetit shërbejnë si një rregullator në sektorët ku tregu nuk është në gjendje t’i rregulloj.

të cilën tregu e mundëson. Duke realizuar këtë kombinim mundësohet të funksionoj ekonomia bashkëkohor duke aktivizuar njërin mekanizëm kur mekanizmi tjetër dështon (Bexheti, 2007).

1.2 Zhvillimi historik i të ardhurave publike

Thelbi kryesor i ekzistimit të sistemeve tatimore në botë është kryesisht sigurimi i mjeteve financiare të njohura si të ardhurat publike, të cilat i realizon shteti më qellim të financimit të shpenzimeve publike. Për tu definuar si të ardhura publike është e rëndësishme të plotësohen tri komponentë të cilat konsiderohen si karakteristikat kryesore të ardhurave publike e ato janë: 1) *Janë mjete financiare*; 2) *Të ardhurat realizohen nga shteti*; 3) *Shfrytëzohen nga shteti për financimin e shpenzimeve publike*. Duke u bazuar në këto tri karakteristika është bërë përcaktimi i të hyrave publike, të cilat janë të ndërlidhura direkt me formën e zhvillimit të shtetit si dhe nivelin e zhvillimit ekonomik.

Nëse analizohet në aspektin historik, zhvillimi i të ardhurave publike është i ndërlidhur direkt me sistemin në të cilin është organizuar shteti, në shtetet skllavopronar burimi kryesor i të hyrave publike ishte pasuria e shtetit të cilën e kishin rritur duke mbledhur tatime më dhunë nga populli të cilët i kishin nënshtruar, ndërsa një pjesë të vogël të hyrave i mbledhin edhe nga shtresat e privilegjuara të qytetareve. Pra gjatë kësaj periudhe të hyrat publike mbledheshin kryesisht nga pasuria e shtetit, konfiskimi, të ardhurat nga doganat, si dhe kontributet të cilat kryesisht janë mbledhur nga shtresat e nënshtruara të popullit.

Në epokën e shteteve feudale, të ardhurat publike kryesisht i grumbullojnë përmes një rente feudale të cilën e paguanin bujkrobërit. Gjatë periudhës feudale burimet kryesore të ardhurave publike kryesisht ishin: të ardhurat domeniiale, konfiskime të luftës, dhuratat dhe donacionet, të ardhurat nga tregtia shtetërore, të ardhura nga doganat, eksportet, importet si dhe të ardhurat nga tatimet. Gjatë feudalizmit është vërejtur lufta për pushtetin financiar në shtet nga pushtuesit në njërin anë dhe fiseve e klerikëve në anën tjetër. Kjo periudhe e ka karakterizuar pikëpamja se pushtuesit janë shteti andaj nevojat e pushtuesit do të konsiderohen si nevoja të shtetit. Andaj edhe pasurit shtetërore janë shfrytëzuar më qellim të plotësimin të këtyre nevojave. Gjatë periudhës kapitaliste shtetet kryesisht zhvillojnë një strukturë të ardhurave të cilat dallojnë nga shtetet feudale, edhe për faktin se shtetet kapitaliste karakterizohen më një strukturë më të gjere të organizimit andaj kërkohet më

shumë të hyra publike me qëllim të mbulimit të shpenzimeve publike. Instrumenti kryesor i sigurimit të hyrave publike është tatimi, të cilët kanë një rol thelbësor si instrumenti financiarë përmes të cilit mblidhen pjesa më e madhe e të hyrave publike (Bexheti, 2007).

1.3 Konceptet kryesore rreth tatimeve

Tatime janë të ardhura në para të cilat i mbledh shteti përmes mekanizmave të ti, ku niveli i tatimeve dhe struktura e tyre përcaktohet përmes dispozitave ligjore. Mjete financiare të mbledhura përmes tatime janë të pakthyeshme dhe nuk pritet një kompensim direkt i paracaktuar për pagesën e tatimit të realizuar.

Egzistojn përkufizime të ndryshme rreth tatimeve mirëpo vlen të theksohet përkufizimi i bërë nga K. Neumark, ku thekson së: “ *Nga dhurimet formale paraprake vullnetare, përmes dhënieve dhe bartjeve edhe më tutje mbi bazë vullnetare, por me prezencë dominuese të elementeve të detyrueshme, janë zhvilluar tatimet si të ardhura juridike të detyrueshme*”. Sipas këti përkufizimi mund të theksohet një element kryesorë së të ardhurat e mbledhura nga tatimi janë të ardhura publike të cilat janë ligjërish të obligueshme të paguhen nga qytetaret, si dhe këto mjete financiare shfrytëzohen më qëllim të mbulimit të shpenzimeve publike të cilat i realizon shtetit me mekanizmat e ti (Bexheti, 2007).

Nëse analizohet aspekti historik i zhvillimit të terminologjisë rreth tatimeve, është e rëndësishme të përmenden karakteristikat kryesore të cilat janë prezentë pothuajse në çdo përkufizim rreth tatimeve, këto karakteristika janë:

- *Imponimi i tatimeve*- Tatime janë të ardhura të cilat shteti përmes dispozitave ligjore i bënë të obligueshme, mbi bazën e sovranitetit të cilin e ushtron;
- *Moskthimi i tatimeve*- Tatime janë të pakthyeshme të cilat e ndërrojnë strukturën dhe titullarin, përmes pagese së tatimeve behet bartja e një pjese të ardhurave nga sektori privat tek sektori publike, pa detyrim kthimi;
- *Mungesa e kompensimit të drejtpërdrejtë*- realizimi i pagesës se tatimeve nuk përmban në vete kompensim të drejtpërdrejt, kjo është karakteristika kryesore të cilin e dallon konceptin e tatimeve me taksat. Tatimet paguhen për shkak së janë obligime ligjore dhe nuk merr përfitim direk nga pagesa e tatimeve, ndërsa në rastin e taksave pagesa e një takse nënkupton qe personi merr direkt një shërbim apo dokument nga institucionet shtetërore;

- *Padestinushmeria e tatimeve*- mjetet e mbledhura nga tatimet nuk kanë një destinim paraprak të përcaktuar, mirëpo mjetet e mbledhura nga pagesa e tatimeve grumbullohen në buxhetin e shtetit dhe të cilat shpërndahen përmes procesin të buxhetit realizohet shpenzimi i tyre duke synuar përmbushjen e objektivave dhe funksioneve të cilat i ka shtetit;
- *Mblidhen në para dhe janë të ardhura të shtetit, si dhe mblidhen për interes publike*- Tatimet mblidhen vetëm në vlera monetare dhe shfrytëzohen me qëllim të sigurimit të mirave publike.

1.4 Llojet kryesore të tatimeve

Klasifikimi i tatimeve është një nga elementet më interesante në literaturën e financave publike, ku ekzistojnë mendime dhe përkufizime të ndryshme së si duhet të klasifikohen tatimet në një sistem tatimore. Disa nga kategoritë kryesore të klasifikimit të tatimeve janë:

1. *Tatime e drejtpërdrejta si dhe tatime e tërthorta*- në kuadër të këtij klasifikimi tatimet e drejtpërdrejta janë kryesisht tatimet të cilat drejtpërdrejt ngarkohet personi e në kuadër të kësaj kategorie përfshihen tatime në të ardhura personale si dhe tatimet në pasuri. Ndërsa ato tatime të cilat karakterizohen si tatime të tërthorta kryesisht janë tatimet e vendosura në konsum apo tatime në transferet e pasurisë.

2. *Tatime e pëe apo speciale*- ky klasifikim i tatimeve varet direkt nga fakti së një tatim a vendosen për të gjitha kategoritë apo vetëm për një kategori të caktuar. Në kategorinë e tatimeve të për përfshihet edhe tatimi në të ardhura personale, pra ku taten të gjitha të ardhurat personale pa marr parasysh burimin e sigurimit të tyre, ndërsa tatimet speciale janë ato tatime të cilat vendosen vetëm për një element të caktuar si për shembull tatimi në të ardhura nga qiraja apo nga renda, pra specifikohet lloji i të ardhurave të cilat taten.

3. *Tatimet “ ad valoriem ”*, paraqesin tatimet të cilat për bazë tatimore kanë vlerën e produktit e shprehur në të ardhurat e realizuara, vlera e mallrave apo vlera e pasurisë, ndërsa tatimet e specifikuar për bazë të llogaritjes marrin sasinë e prodhimit, peshën vëllimin etj (Bexheti, 2007).

Ekzistojnë shumë përkufizime nga autor të ndryshëm së si duhet të klasifikohen tatimet, mirëpo vlen të theksohet klasifikimi i bërë nga OECD-ja, ku kategoritë kryesore të tatimeve janë të prezantuara në katër grupe kryesore:

- Tatimet në të ardhura (Tatimet në të ardhurat personale dhe fitimet)
- Tatime në pasuri
- Tatime në Konsum

- Tatimet në kontribute për siguri të detyrueshme shoqërore

Në kuadër të këtyre klasifikimeve përfshihen edhe nën klasifikimet tjera si: Tatimet në të ardhurat personale, tatimet në kapital, kontributet pensionale dhe shëndetësore, tatimet në neto pasuri, tatimet nga transaksionet financiare, tatimet në prodhim, tatimet në qira, tatimet në qarkullim, tatimi mbi vlerën e shtuar, etj.

1.5 Parimet kryesore rreth tatimeve

Përcaktimi i sistemit tatimore është i ndërlidhur direkt me parimet e tatimeve të cilat kryesisht klasifikohen në kate kategori kryesore të njohura si “*Katër rregullat fillestare tatimore të Adem Smithit*”, të cilat janë: *barazia e trajtimit; saktësia dhe siguria e taksës për t’u paguar; lehtësia dhe leverdia ekonomike e vjeljes*, sipas Smithit këto ishin parimet kryesore të cilat duhet pasur parasysh gjatë përcaktimit të sistemit tatimorë.

Ndërsa është e rëndësishme të prezantohen edhe parimet e prezantuar nga teoricienit gjerman i cili parimet themelore të tatimit i sistemon në katër grupe: *Parimet financiare në të cilën përfshihen elementet e produktiviteti dhe elasticitetit; Parimet ekonomike; parimet socio politike; parimet tekniko-tatimore*. Sipas Nobelistit Xhozef Stiglic, karakteristikat kryesore të preferuara të çdo sistemit tatimore janë të grumbulluara në pesë kategori kryesore të cilat janë: *Efikasiteti ekonomik; thjeshtësia administrative; sistem tatimore elastik; përgjegjësia politike, si dhe drejtshmëria e sistemit tatimore*. Për të kuptuar funksionimin e sistemeve tatimore të cilat do të trajtohen në pjesën e dytë të punimit është e rëndësishme të trajtohen në pika të shkurta kuptimi i këtyre parimeve të tatimeve (Bexheti, 2007).

- Sipas *parimit financiar* qëllimi kryesor ndërlidhet me faktin se përcaktimi i normave tatimore duhet të synojnë nivelin më të lartë të produktivitetit financiarë përmes të cilit synohet që të zgjidhet sistemi tatimore më i përshtatshëm përmes të cilit synohet të mblidhen mjete financiare të mjaftueshme për financimin e shpenzimeve publike. Gjithashtu sistemet tatimore të përcaktuara duhet të karakterizohen më shkallë të lartë të elasticitetit me të cilin mundësohet përshtatje më e mire e sistemit tatimore më nivelin e zhvillimit ekonomik të shtetit.
- Sipas *parimit ekonomik* sistemi tatimore përdoret si një instrument aktiv i politikave fiskale përmes të cilëve mundësohet intervenimi direkt në ekonomi përmes të cilave veprime shkaktojnë efekte direkt në mikroekonomike dhe makroekonomike, përdorimi i tatimeve është një nga instrumente më të theksuara të cilët përdoren nga

institucionet shtetërore me qëllim të menaxhimit të krizave ekonomike por dhe si instrumente të rëndësishme të promovimit të zhvillimit ekonomik.

- Sipas *parimeve sociale-politke*, gjatë përcaktimit të sistemit tatimore është fundamentale që gjatë përcaktimeve të detyrimeve tatimore të respektohet gjithpërfshirja, ku tatimet të paguhen nga të gjithë pavarësisht nga pozita e tyre ekonomike apo shoqërore.

1.6 Konceptet kryesore rreth ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Regjistrimi i bizneseve behet pran Asgjësisë për Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë e njohur si ARBK, e cila funksionon si organ qendrore i administratës shtetërore në kuadër të Ministrisë. ARBK-ja është i vetmi institucion i vili ka juridiksion në tërë territorin e Kosovës, ku përmes ofrimit të shërbimeve në sportelet e saj Qendrore dhe në qendra të regjistrimit në Komuna. Me rastin e regjistrimit fillestar të shoqërisë tregtare gjenerohet edhe numri unik identifikues i cili shërben si numër për identifikimin e biznesit qoftë për qëllimi tatimore, por dhe për qëllime tjera administrative ose juridike.

Bizneset të cilat deshriojn të ushtrojn veprimtarin ekonomike në Republikën e Kosovës, duhet të jene në përputhje të plot më dispozitat ligjore të cilat e rregullojn fushen e veprimtaris ekonomike sipas ligjit nr. 06/L-06 Për shoqëritë tregtare, percaktohen llojet kryesore të regjistrimit të bizneseve të cilat janë: Bizneset Individuale, Ortakëri të përgjitheshme, ortakëri të kufizuar apo edhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuar apo shoqëri aksionare. Ndersa perveq ketyre kategorive egziston mundësia që në Kosovë mund të regjistrohën edhe këto kategori të bizneseve të cilat janë: Degte e bizneseve të huaja tregtare, zyret e përfaqësive të huaja, ndermarrje publike si dhe ndërmarrje shoqërore të cilat menaxhohen nga AKP-ja.

Biznes Individual, sipas ligjit mbi shoqërit tregtare biznesit Individual konsiderohet kur egziston vetëm një pronar i cili është përgjegjes ndaj obligimev dhe gjitha detyrimeve të cilat shkaktohen nga biznesi. Karakterisitika kryesore e kësaj kategoria të bizneseve është përgjegjesia ligjore e pakufizuar me të cilen nenkuptohet së pronari i biznesit është përgjegjes i drejtperdrejt me gjithë pasurin e ti, duke i përfshi të gjitha pronat, duke përfshir asetet, apo çfarë do llojë të pasuris të cilat janë në pronësi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë

duke mos pasur parasyesh nëse prona është përdorur apo shfrytëzuar për qëllime afariste apo për qëllime personale.

Ortakëria e Përgjithshme është shoqëri Tregtare në të cilën ortakët e përgjithshme janë personat fizik ose juridik, të cilët përmes marrëveshjes së ortakërisë i përcaktojnë detyrimet dhe përgjegjësit e tyre me rasti në themelimit. Ortakëria e përgjithshme përbehet nga ortakët të cilët mund të jenë persona fizik ose juridik, të cilëve ju takon e drejta në ndarjen e fitimit dhe shpërndarjen e dividendes, gjithashtu të gjithë ortakët individualisht dhe kolektivisht përgjegjës për të gjitha borxhet dhe detyrimet kontraktuale ose ligjore të Ortakërisë së Përgjithshme, kjo përgjegjësi është e pakufizuar dhe përfshin të gjitha pasuritë dhe asetet të cilat janë në pronësi të drejtpërdrejt nga ortaku i përgjithshëm.

Ortakëri e Kufizuar, nuk konsiderohet si person juridik pavarësisht faktit se mund të lidh kontrata të posedojë pronë, të ushtroj padë por dhe të paditet në emirin e saj, sipas kësaj strukture të organizimit një orgak më përgjegjësi të kufizuara nuk është përgjegjës për obligimet ose borxhet e ortakërisë. Përcaktimi i detyrimeve dhe përgjegjësi bëhet përmes marrëveshjes së ortakërisë së kufizuar përmes të cilet përcaktohet niveli i përfitimeve dhe përgjegjësit për secin anëtar të ortakërisë së kufizuar.

Shoqëri më përgjegjësi të kufizuar, është personi juridike i cili është juridikisht e ndarë nga aksionarët, është vetvetiu bartëse e të drejtave dhe obligimeve, aksionaret në një formë të tillë të organizimit përgjegjësit i kanë të kufizuar në baze të ndarjes së pronësisë, e cila ndarje bahet në baze të aksioneve të cilat i posedon. Një shoqëri më përgjegjësi të kufizuara mund të ketë për aksionarë një ose më shumë persona fizik ose juridik apo edhe shoqëri tregtare, ndërsa vetëm organizatat joqeveritare nuk mund të jenë aksionar në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara.

KAPITULLI II

ZHVILLIMI I SISTEMIT TATIMOR NË KOSOVË

2.1 Definimi i termeve rreth sistemeve tatimore

Vet definimi i termit të sistemit tatimore është një qeshtje e rëndësishme për tu trajtuar, ku përkundër të gjitha përkufizimeve është ë vështir të gjendet një përkufizim i pranuar nga të gjithë rreth përkufizimit të sistemit tatimore. Sistemit tatimore mund të përkufizohet si tërësia e të gjitha institucioneve shtatore si dhe formave tatimore të cilat përdoren më qëllim të realizimit të objektivave të një shteti. Gjithashtu sistemit tatimore mund të përkufizohet si një përmbledhje e të gjitha formave tatimore të cilat veprojnë brenda sistemit ekonomik, politik, dhe shoqërore me qëllim të vetëm përmbushjen e objektivave fiskale, ekonomike dhe zhvillimore të shoqërisë në përgjithësi.

Mënyra e organizimit të sistemeve tatimore është direkt e lidhur më objektivat të cilat synon shteti të i realizoj duke përdorur politiken tatimore si instrument për përmbushje e këtyre objektivave. Në ekonomin kapitaliste rëndësia e sistemeve tatimore nuk ndërlidhet vetëm me aspektin fiskal dhe të mbledhjes së tatimeve më çdo kusht për përmbushjen e objektivave fiskale të shtetit, sistemet bashkëkohore tatimore janë në funksion të nevojave të gjithmbarshme shoqërore ku përfshihen nevojat sociale, politike, kulturore si dhe të zhvillimit ekonomik.

Në ekonomin bashkëkohore eksitojnë sisteme tatimore të përbëra nga një shumëllojshmëri tatimesh qe njihen si sisteme pluralizëm tatimore, por ekzistojnë edhe shtete në të cilat sistemi tatimore është organizuar si sistem monist tatimore në të cilin sistem propozoje të zbatohet vetëm një tatim i njohur si sistemi tatimore linear, ku përcaktohet vetëm një normë e vetme tatimore e cilat është e shpërndara në formë lineare për të gjithë anëtarët e shoqërisë. Një sistem i tillë është kundërshtuar shumë nga teoricienët ekonomik për shkak se nuk përmban në vete edhe aspektin social por dhe ekonomik. Ndërsa sistemet jolinerare të promovuar shumë në ekonomin bashkëkohore karakterizohet një game e gjerë e tatimeve të cilat si karakteristika kanë një normë progresive të tatimeve. Funksionimi i sistemeve

tatimore është i ndërlidhur direkt më ndryshimet në rrethanat politike, ekonomike, dhe shoqërore në përgjithësi, më ndryshimin e këtyre rrethanave bëhet e obligueshme të ndryshohen edhe sistemet tatimore (Bexheti, 2007).

2.2 Sistemit tatimore në Kosovë

Përcaktimi i obligimit për të paguar detyrimet tatimore të përcaktuar më bazën ligjore është pjese përbërëse e Kushtetutës së Kosovës, ku në kapitullin e IX Marrëdhëniet Ekonomike, parimet e përgjithshme pika 8 theksohet së: *“Secili person është i obliguar të paguajë tatimet dhe kontributet e tjera të parapara me ligj”*. Kosova karakterizohet më një sistem fiskal mirë të zhvilluar e kjo fal bashkëpunimit më faktorë ndërkombëtare të cilët gjatë krijimit të sistemit tatimore janë bazuar në përzgjedhjen e politikave por gjithashtu dhe përvojave me të mira të cilat janë implementuar nga vendet e Bashkimit Evropian, në këtë formë ligjet e Kosovës janë përafuar me legjislacionin e BE-së. Kjo vlen për tatimet dhe politikat doganore duke përfshirë tatimet direktë dhe indirekte (Tatimi në të Ardhurat e Korporatave, Tatimi në të Ardhurat Personale, Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, Dogana, Akciza, etj).

Administrata Tatimore e Kosovës është i vetmi Autoritet që administron tatimet, nxjerrë rregulla të për administrative të cilat janë të detyrueshme të zbatohen si për Administratën Tatimore, ashtu dhe për Tatimpaguesit. Qëllimi kryesor i funksionimit të ATK-së lidhet direkt me sigurimin e një ambientit të përshtatshëm të zbatimit të dispozitave ligjore por dhe hartimin e rregulloreve dhe zbatimin e tyre, të cilat kanë të bëjnë me tatimet. Përgjegjësit e administratës tatimore janë të përcaktuar me ligjin mbi administratën publike dhe kanë të bëjnë më administrimin e tatimeve në nivel qeveritar, siç janë: TVSH në afarizmin vendor, Tatimin në të Ardhurat Personale, Tatimin në të Ardhurat e Korporatave dhe Kontributet Pensionale (ATK, Administrata Tatimore e Kosovës, 2022).

Dispozitat ligjore të cilat i rregullojnë funksionimin e sistemit tatimore në Kosovës ishin prezence qe nga data 12 Prill e vitit 2000, kur ishte miratuar rregullorja e UNMIK-ut, rregullorja “ Mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore”. Ndërsa më qëllim të harmonizimit të ligjit më praktikat të mira ndërkombëtare dhe me standardet evropiane është miratuar për here të parë ligji më numër 20004/48 “ *Ligji për Administratën tatimore dhe Procedurat*”. Me qëllim të harmonizimit pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës është bërë

edhe ndryshimi i Ligjit për Administratën Tatimore me datën 06.12.2008 me numër 2008_03_L071.

Me qëllim të rregullimit të dispozitave ligjore të sistemit tatimore, Kosova ka aprovuar këto dispozita ligjore:

- Ligjin nr. 05/L-37“ *Për tatimin mbi vlerën e shtuar*” me datën 01.09.2015,
- Ligjin nr. 05/L-28 “ *Për tatimin në të ardhura personale*” me datën 01.09.2015,
- Ligjin nr. 06/L-105 “ *Për tatimin në të ardhura të korporatave*” me datën 09.09.2019,

Këto dispozita ligjore janë edhe sot në fuqi dhe përmes këtyre përcaktohet korniza ligjore e funksionimit të sistemit tatimore në Kosovë, duke u mbështetur edhe më udhëzimet administrative dhe rregulloret e hartuara nga Administrata Tatimore e Kosovës.

2.3 Tatimi në të Ardhurat e Korporatave

Tatimi në të ardhura të Korporatave është i rregulluar në baze të ligjit nr. 06/L-105, me datën 09.09.2019. Tatimi në të Ardhurat e Korporatave aplikohen në të ardhurat e realizuara nga korporatat brenda një periudhe tatimore (vite kalendarik), ku normat tatimore janë të ndërlidhura direkt me nivelin e të ardhurave bruto vjetore të realizuara. Për korporatat të cilat kanë qarkullim prej 50 mijë euro apo më pak, taten ne shkallen prej 3% për veprimtarit si tregtia, bujqësia por dhe veprimtarit ngjajshme. Ndërsa për kompanitë shërbyese të cilat ofrojnë shërbime profesionale, është norma tatimore rreth 9 %. Ndërsa për bizneset të cilat kanë një qarkullim financiare mbi 50,000 euro aplikohet norma tatimore 10% e të ardhurave para tatimit.

Në çdo dispozitë ligjore e cila rregullon procesin vendosjes së një norme tatimore, elementin kryesore e ka përcaktimin e objektit të tatimit, ku sipas ligjit mbi të ardhurat e korporatave objekti i tatimit janë rezidentet të cilat krijojnë të ardhura si brenda Kosovës ashtu edhe jashtë tyre, gjithashtu edhe jorezidentet për të ardhurat të cilat i kanë krijuar ne Kosovë. Sipas këtij ligji të ardhurat e tatueshme përfshihen të ardhurat të cilat i realizon korporata brenda një periudhe tatimore, pra të ardhura të tatueshme konsiderohen të ardhurat bruto të pranuar pasi janë zvogëluar zbritjet e lejueshme. Sipas ligjit për tatimet në Korporata si tatim pagues konsiderohen korporatat, shoqëritë tregtare, ndërmarrjet afariste por dhe shoqëritë tregtare të cilat mund të jenë në pronësi shoqërore apo edhe ato të cilat janë në pronësi publike.

Sipas këtij ligji ekzistojnë disa kategori të hyrave të cilat janë të liruara nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave, këto të hyra janë: Të hyrat e realizuara nga OJQ-të, të ardhurat e realizuar nga BQK-ja, të hyrat e institucioneve financiare ndërkombëtare, të hyrat e realizuara nga interesi për letrat më vlerë të lëshuara nga institucionet shtetërorë, të ardhurat e bashkësive fetare, të hyrat e agjencive të OKB-së, gjithashtu edhe të hyrat KFOR-it, po dhe agjencitë tjera ndërkombëtare të cilët operojnë në Kosovë.

2.4 Tatimi në të Ardhura Personale

Tatimi i të ardhurave personale rregullohet më dispozitën ligjore nr. 05L-28 Ligji për Tatimin në të Ardhurat Personale, kjo dispozitë ligjore aplikohet për të gjitha të ardhurat që një individ pranon brenda një viti kalendarik. Tatimpagues sipas Ligjit për Tatim në të Ardhura Personale, janë: personat fizik rezident dhe jo rezident, ndërmarrja personale afariste, ortakëritë dhe shoqëritë, të cilët pranojnë ose krijojnë të ardhura bruto nga çfarëdo burimi, duke përfshirë pagën, veprimtarinë afariste, qiranë, fitoren në lotari, interesat, fitimet kapitale, shfrytëzimin e pasurisë së paprekshme, pensionet, si dhe çdo të ardhur tjetër që rrit vlerën neto të tatimpaguesit.

Sipas ligjit mbi të ardhurat personale objekti i tatimit janë të ardhurat e realizuar nga rezidentet, të cilët burimin e krijimit e kanë brenda dhe jashtë Kosovës. Ndërsa sa i përket për personat jorezident objekt i tatimit janë të ardhurat të cilat realizohen brenda Kosovës. Gjithashtu është e rëndësishme të sqarohet se sipas këtij ligji periudha tatimore konsiderohet viti fiskal. Sipas këtij ligji në të ardhura personale bruto përfshihen të gjitha të ardhurat që realizohen nga paga, aktivitetet afariste, të hyrat nga qiraja, të hyrat nga pasura e paprekshme, të hyrat nga interesit, lotaria si dhe të hyrat tjera.

Sipas këtij ligji për bizneset individuale të cilat kanë një qarkullim financiar më pak se 50 mijë euro, dhe ushtrojnë veprimtari në fushën e tregtisë, veprimtarit e ngjashme komerciale, transport apo dhe bujqësi tatóhet më një normë tatimore rreth 35. Ndërsa për veprimtarit shërbyese profesionale të cilat nuk kanë një qarkullim mbi 50 mijë euro tatóhen më një normë tatimore rreth 9% e qarkullimit. Ndërsa për bizneset të cilët kanë të ardhura mbi 50 mijë euro apo të cilat kanë përzgjedhur vullnetarisht të implementimet e tatimit në të ardhura reale, ku normat tatimore janë sipas këtyre shkalleve:

Tabela nr. 1. Normat Tatimore mbi të ardhurat personale

Norma Tatimore	Të ardhurat Mujore	Të ardhurat Vjetore
0%	0 deri 80	0 deri 960
4%	80 deri 250	960 deri 3000
8%	250 deri 450	3000 deri 5400
10%	450 euro më shumë	5400 euro më shumë

Burim: Ligji mbi të ardhurat personale

Në kuadër të ardhurave personale një kategori e veçanta është edhe të ardhurat e realizuar nga paga si një kategori e rëndësishme e të hyrave publike, ku në kuadër të hyrave bruto nga paga përfshihen këto të hyra: Rroga, premitë e sigurimit, bonuset, mbulimi i shpenzimeve të transporti, falja e huas, mëditjet si dhe forma tjera të hyrave të cilat i realizon punëtori në formë të kompensimit.

Për tatimpaguesi të cila të ardhurat e tyre i sigurojnë përmes pagës si e hyrë nga një burim, ku punëdhënësi i ka ndaluar tatimin në burim, atëherë ky person nuk është e nevojshme të dorëzojnë në administratën tatimore deklaratën vjetore të obligimeve tatimore. Tatimpaguesit që pranojnë apo që realizojnë të ardhura prej vetëm një burimi si paga e cila ka qenë subjekt i mbajtjes në burim, nuk janë të detyruar të dorëzojnë deklaratë tatimore vjetore. Ndërsa për punëtoret të cilët nuk e kanë punë primare po ushtrojnë si punë sekondare, atëherë punëdhënësi është i obliguar ti ndalë dhjetë përqind të pagës së tatueshme. Ndërsa për punëtoret të cilët e kanë punë primare, atëherë punëdhënësi është i obliguar të ngaltë tatimin në burim sipas këtyre normave tatimore:

Tabela nr.2. Normat tatimore mbi pagën

Norma Tatimore	Të ardhurat Mujore
0%	0 deri 80
4%	80 deri 250

8%	250 deri 450
10%	450 euro e më shumë

Burimi: Ligji i të ardhurave personale

Punëdhënësi është i obliguar që të ndal në pagën bruto shumën prej 5% si kontribut pensional, gjithashtu përmes të ardhurave të biznesit është i obliguar ti paguaj shumën prej 5% të pagës bruto si kontribut pensional i punëdhënësit, kjo vlen për të gjithë të punësuarit qofshin punëtor primare apo sekondar.

2.5 Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH-ja)

Përcaktimi i tatimeve indirekte apo të njohura si tatimet në konsum, në Kosovë përcaktohen përmes ligjit nr. 05/L037 *Për tatimin mbi vlerën e shtua*, ku në vitin 2017 është përshkallëzuar normat tatimore e TVSH-së, ku është përcaktuar norma prej 8 përqind e vlerës së furnizime për produkte si ujë, furnizimi më energji elektrike, produkte e drithërave, vajrat për ushqim, produkte e qumështit, si dhe librat shkollor. Ndërsa për të gjitha produkte apo shërbime tjera është mbajtur në fuqi norma 18% e TVSH-së. Më qëllim të përafrimi më praktikat e mira të Bashkimit Evropian, furnizimet dhe shërbimet të cilat eksportohen janë të lira nga TVSH-ja. Normat tatimore të TVSH-së aplikohen në të gjitha mallrat por dhe shërbime të cilat importohen dhe kanë për qëllim të shiten për konsum final. Pra sipas këtij ligji objekti i tatimit janë të gjitha transaksionet të cilat ndodhin brenda Kosovës pa marr parasysh a janë shërbime apo mallra, pra çdo furnizim apo shërbim i cili kryhet kundrejt një pagese, duhet të ngarkohet tatimi nga një biznes i tatueshëm i cili e ushtron aktivitetin e në Kosovë.

Gjithashtu me këtë ligje aplikohet norma e tatimit mbi vlerën e shtuar në importimin e mallrave. Është e rëndësishme të sqarohet së sipas këtij ligji person i tatueshëm është çdo person qoftë ky individ, person fizik ose juridik, ose i organizuar në çdo formë tjetër të njohur nga legjislacioni në Kosovë, i cili në mënyrë të pavarur kryen veprimtari ekonomike sipas kuptimit të Ligjit, pavarësisht vendit, qëllimit, ose rezultatit të kësaj veprimtarie.

Çdo person që i përmbush të gjitha kushtet e përkufizimit mbi personin e tatueshëm, kërkohet që të regjistrohet për TVSH, nëse brenda vitit kalendarik tejkalon qarkullimin prej tridhjetëmijë euro (30.000€). Vetëm pjesa e furnizimit e cila rezulton në tejkalimin e qarkullimit, do të merret parasysh për qëllime të TVSH-së. Çdo person i tatueshëm i regjistruar në TVSH në mënyrë të detyrueshme apo vullnetare, mund të kërkojë nga ATK që të çregjistrohet për qëllime të TVSH-së, nëse gjatë vitit të fundit kalendarik, qarkullimi i tij ka rënë nën pragun e paraparë me nenin 6 paragrafi 1 i Ligjit.

Çdo furnizim për mallra apo shërbime duhet të ngarkohet norma e TVSH-së, atëherë kur ndodhë furnizimi i mallit apo shërbimit. Pra normat e TVSH-së duhet të ngarkohen në momentin kur të ndodhë lëshimi i faturës, apo pranimi i pagesave ose kur ndodhë pranimi i mallrat apo shërbimit. Pra duhet pasur parasysh së në momentin që ndodhë njëra na këto raste duhet të aplikohen normat tatimore.

KAPITULLI III

TË HYRAT TATIMORE DHE TRENDI I TYRE PËR PËRIUDHËN 2017-2022

3.1 Trendi i të hyrave tatimore

Administrata Tatimore e Kosovës, është karakterizuar më një performanc të lart në mbledhjen e të hyrave tatimore ku për periudhën 2017- Qershor 2022, është karakterizuar më një rritje pozitive të hyrave ku kategoritë më kryesore janë të hyrat nga tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi pagat si dhe tatimi mbi korporata dhe llojet tjera (ATK, Raporti i Punës Janar-Dhjetor, 2021).


Tabela nr. 3. Të hyrat sipas llojeve të tatimit për periudhën 2017- Qershor 2022

Lloji i Tatimit	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Tatimi mbi vlerën e shtuar	196,635,189	215,184,335	241,711,051	223,138,952	292,911,419	158,571,095
Tatimi mbi pagat	86,561,097	98,020,968	108,418,434	112,170,886	129,859,010	68,514,808
Tatimi Bizneset Individuale	35,148,476	34,067,683	32,948,635	26,407,181	33,842,184	22,369,794
Tatimi mbi Qeran	18,073,875	22,177,062	25,911,208	19,842,154	26,635,797	14,041,585
Tatimi në Korporata	77,936,657	87,348,447	95,292,538	85,480,660	114,454,395	92,031,159
Totali	414,355,294	456,798,495	504,281,866	467,039,833	597,702,805	355,528,441

Burimi: Raportet Vjetore të ATK-së

Të ardhurat e mbledhura për periudhën 2017 deri në periudhën Qershor 2020 në total janë grumbulluara rreth 2.80 miliard euro, ndërsa sipas llojeve të tatimit kategoria kryesore është tatimi mbi vlerën e shtuar ku në total janë mbledhur rreth 1.3 Miliard euro apo shprehur në përqindja 48% të të hyrave tatimore të periudhës 2017-2022, duke vazhduar me tatimin në të ardhurat nga paga me rreth 604 milion euro apo 22%, pastaj tatimi në të ardhura të Korporatave me rreth 20%, apo rreth 553 milion euro, tatimit për bizneset individuale rreth 185 milion euro apo rreth 7% si dhe tatimi mbi qira ne shumen prej 127 milion euro apo shprehur në përqindje rreth 5% e totalit.


Grafikoni nr.1 Pjesëmarrja e tatimeve për periudhën 2018-2022



Burimi: Raportet vjetore të ATK-së

Sipas të dhënave të propozuar me lart mund të konstatohet së ekziston një trend pozitiv në mbledhjen e të hyrave tatimore me kalimin e viteve është rritur konsiderueshëm edhe mbledhja e obligimeve tatimore. Kjo mund të prezantohen edhe grafikisht, ku mund të konstatohet trendi pozitiv, përveç vitit 2020 kur për shkak të mbylljes së ekonomisë nga pandemia kishte zvogëlim në të hyrat e realizuara nga Administrata Tatimore e Kosovës. Ndërsa të dhënat e prezantuara për vitin 2022 janë vetëm për gjashtëmuorin e pare të vitit 2022.

Grafikoni nr.2 Trendi i të hyrave tatimore për periudhën 2017- Qershor 2022



Burim: Raporte vjetore të ATK-së

Sipas grafikoni të prezantuar më lartë, mund të konstatohet së të hyrat e mbledhura nga administrata tatimore për vitin 2017 ishin mbledhur rreth 414 milion euro, për vitin 2018 rreth 456 milion euro apo rreth 9% më shumë, për vitin 2019 rreth 504 milion euro apo rreth 8% më shumë, për vitin 2020 kemi pas një renje prej 22% në të hyrat e mbledhura për shkak

të pandemisë në rreth 467 milion euro, për vitin 2021 ishin mbledhur rreth 597 milion euro apo rreth 68% më shumë se në vitin 2020.

3.2 Të hyrat tatimore sipas regjioneve

Në shumën e përgjithshme të hyrave të realizuara për këtë periudhë prej vitit 2017 deri me 31 Qershor 2022 në vlerë prej 2,795 milion EUR, Departamenti i Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM) merr pjesë me 49%, apo shprehur në vlerë mbi 1,298 milion EUR, pastaj regjioni Prishtina 1 me 10%, apo shprehur në vlerë mbi 198 milion EUR, Prishtina 3 me 8 %, Prishtina 2 me 7%, Zyra Qendrore me 7%, Ferizaj me 4%, Gjilani me 3%, Prizreni 1 me 3%, Peja me 3%, Mitrovica me 2%, Prizreni 2 me 2%, ndërsa Gjakova me 2%.

Tabela 4. Të hyrat tatimore sipas Regjioneve për periudhën 2017- Qershor 2022

Regjioni	2017	2018	2019	2020	2021	2022
DTM	204,125,517	211,690,757	237,018,678	220,234,370	256,309,713	169,282,446
Prishtinë 1	41,093,121	50,164,404	54,793,352	54,211,278	77,543,408	45,522,475
Pri shtinë 2	28,369,264	32,445,845	33,442,766	31,297,702	47,493,065	25,318,315
Pri shtinë 3	33,624,151	38,943,703	41,267,018	37,987,845	54,136,451	27,220,869
Gjilan	12,218,093	13,971,836	14,860,714	12,998,505	19,790,800	9,378,439
Ferizaj	14,676,999	15,884,717	17,647,317	15,288,444	25,175,809	13,853,916
Prizren 1	11,820,276	14,348,337	16,873,219	13,929,709	19,777,050	12,341,545
Prizren 2	9,954,464	11,910,552	13,597,595	11,232,737	16,182,838	8,035,020
Gjakovë	6,563,899	7,857,175	8,860,573	7,798,259	9,325,506	6,103,555
Pejë	12,684,282	14,044,638	15,072,821	12,293,517	18,376,951	10,459,072
Mitrovicë	10,055,283	12,926,929	13,024,547	11,755,532	16,778,670	9,880,582
Z.Qendrore	29,169,945	32,609,602	37,823,265	38,011,935	36,812,544	18,132,209
Totali	414,355,294	456,798,495	504,281,865	467,039,833	597,702,805	355,528,443

Raportet vjetore të ATK-së

Sipas të dhënave të prezantuara më lartë, mund të konstatohen regjionet në të cilat është realizuar mbledhja e obligimeve tatimore, mirëpo është e rëndësishme të paraqitet edhe shpërndarja e obligimeve të papaguara, ku në total me datën 31.12.2021 janë rreth 429 milion euro borxhe të papaguara, ku sipas regjioneve është kjo gjendje:

Tabela 5. Tatimet e Papaguara sipas regjioneve

Regjioni	Tatimet e Papaguara
DTM	30,597,616.96
Prishtinë 1	87,674,968.84
Prishtinë 2	40,806,848.82
Prishtinë 3	49,139,507.00
Gjilan	32,202,055.90
Ferizaj	44,552,162.93
Prizren 1	27,213,095.87
Prizren 2	27,876,869.95
Gjakovë	30,580,977.2
Pejë	12,029,418.35
Mitrovicë	12,029,418.35
Z. Qendrore	34,740,815.37
Totali	429,443,755.56

Raportet vjetore të ATK-së

3.3 Trendi i zhvillimit të NVM-ve në Kosovë

Tabela 5 më poshtë paraqet numrin e shoqërive tregtare të regjistruara si dhe numrin e shoqërive tregtare të çregjistruara sipas formës ligjore të shoqërive tregtare të definuar me ligj për muaj, të vitit 2021. Numeri më i madh i bizneseve të regjistruara gjatë viti 2021 ishte shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, duke u përcëlluar nga bizneset individuale, degë të shoqërive të huaja tregtare.

Tabela nr.6 Numri i shoqërive tregtare të regjistruara sipas formës ligjore

Lloji i Biznesit	2021	2020	2019	2018
Biznes Individual	3735	3971	4391	4502
Ortakëri e Përgjithshme	8	7	6	13
Ortakëri e Kufizuar,	0	1	0	1
Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	6888	5768	5585	5356
Shoqëri Aksionare	8	11	12	23
Degë e Shoqërive të Huaja Tregtare	56	42	52	55
Zyrë e Përfaqësues të Shoqërive të Huaja Tregtare	3	2	5	7
Ndërmarrjet Publike	0	0	0	0
Ndërmarrjet Shoqërore	0	0	0	
Kooperativa Bujqësore	3	3	3	3
Totali i bizneseve të hapura	10,701	9,805	10,054	9,960

Burimi: Raporte Vjetore të ARBK-së

Sipas të dhënave të cilat janë publike në raportet e ARBK-së, gjatë vitit 2021 janë regjistruar rreth 3735 biznese individuale, ndërsa rreth 6,888 biznese ishin regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, 56 degë të shoqërive të huaja tregtare, 8 ortakëri të përgjithshme, 8 shoqëri aksionare, ndërsa 3 zyre të përfaqësuesve të shoqërisë të huaja tregtare si dhe 3

kooperative bujqësore, në total gjate periudhës Janar-Dhjetor në total janë regjistruar rreth 10,701 biznese.

Tabela nr. 7 Numri i bizneseve që kanë dërguar të dhënat në administratën tatimore

Vitet	2017	2018	2019	2020	2021
Numeri	19,302	20,146	20,894	21,092	23,022

Burimi: Raporte Vjetore të ARBK-së

Bizneset janë të obliguara që ti deklarojnë obligimet tatimore, në administratën tatimore, ku kemi një rritje siginifikante të bizneseve të cilët i deklarojnë obligimet e tyre tatimore duke i përdorur platformën E-deklarimi. Ku gjatë vitit 2021 kanë deklaruar obligimet tatimore rreth 23,022 biznese apo rreth 11% më shumë së një vit paraprak.

Një analizë e rëndësishme të cilët është e rëndësishme të trajtohet gjatë këtij kapitulli ndërlidhet direkt më kontributin të cilët bizneset e kanë në sigurimin e të hyrave publike. Sipas të dhënave të grumbulluara nga raportet vjetore të ATK-së, të hyrat e mbledhura nga tatimet për biznese individuale dhe të hyrat e mbledhura nga tatimi në korporata janë dy nga kategoritë kryesore të sigurimit të hyrave publike.


Tabela nr.8 Të hyrat tatimore nga Bizneset individuale dhe Korporatat

Lloji i Tatimit	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Tatimi për bizneset individuale	35,148,476	34,067,683	32,948,635	26,407,181	33,842,184	22,369,794
Tatimi në Korporata	77,936,657	87,348,447	95,292,538	85,480,660	114,454,395	92,031,159
Totali	113,085,133	121,416,130	128,241,173	111,887,841	148,296,579	114,400,953

Burimi: Raporte Vjetore të ATK-së

Të hyrat e realizuar nga Bizneset Individuale për periudhën 2017 deri me datën 30 Qershor 2022, janë mbledhur 185 milion euro, ndërsa sipas të hyrat e mbledhura nga Tatimi në Korporate përgjatë kësaj periudhe janë mbledhur rreth 553 milion euro. Nëse analizohet me totalin e të hyrave nga të gjitha kategoritë tatimore këto dy kategori të hyrave kanë realizuar rreth 737 milion euro nëse shprehet në përqindje i bje që rreth 26% e të hyrave prej 2,795 milion euro, janë mbledhur nga këto dy komponentë tatimore.

Grafikoni nr.3 Trendi i të hyrave nga tatimet në të ardhurat personale dhe korporatave




Përmes prezantimi grafik mund të konstatohet së ekziston një trend pozitiv linear, me të cilin mund të shihen së rritja pagesave të tatimeve nga bizneset është rritur konsiderueshme të hyrat e mbledhura gjate vitit 2021 janë mbledhur rreth 148 milion euro apo rreth , rreth 30 përqind më shumë së gjatë vitit 2020 gjatë të cilit vit ishin mbledhur 111 milion euro.

3.4 Indeksi i mjedisit fiskal në Kosovë

Një element të rëndësishëm të cilin duhet të trajtohet gjate shtjellimit të sistemit tatimore dhe impaktit që ky sistem ka mbi bizneset në Kosovës, është pikëpamja e bizneseve ndaj sistemit tatimore, ku në anketën e realizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në të cilën mblidhen pikëpamjet e mjedisit fiskal. Indikatorët të cilët janë marr parasysh përfshijnë: Arsyeshmëria e normave tatimore, Efikasitetin e procedurave për rimbursim të TVSH-së, efikasiteti në zgjedhjen e kontesteve në ATK-në dhe doganat, Transparencë dhe qasje fer nga ATK-ja, Funksionimi i mekanizimit për marrjen e këshillave dhe ofrimi i qartësive për bizneset.

Grafikoni nr. 4 Indeksi i mjedisit fiskal



Burimi: Oda Ekonomike Amerikane

Duke u bazuar në shënimet e prezantuara më lartë, sipas bizneseve pjesëmarrëse në anketën e realizuar nga oda ekonomike amerikane, ku vlerësimi i administratës tatimore në aspektin e transparence prezantimin e interpretimeve ligjore si dhe inspektimet fer është konsiderua një shkallë e lare me rreth 5.38. Gjithashtu pozitivisht janë vlerësuar edhe përshtatshmëria e normave tatimore, ku janë konsideruar si të arsyeshme duke u vlerësuar me rreth 5.13. Gjithashtu vlerësim të njëjtë ka pasur edhe aspekti i lehtësirave në ribursimin e TVSH-së. Duhet theksuar se indikator i normave tatimore ka shënuar një përkeqësim në vlerësim nga mesatarja prej 6.55 në 2019 në 5.13, gjate viti 2021, edhe përkundër faktit së normat tatimore nuk ishin ndryshuar gjate kësaj periudhe. Ndërsa shkallen e vlerësimit sipas përgjigjeve të marra nga kjo ankete ne se paku është vlerësuar procesi i ofrimit të këshillave për bizneset me vetëm 4.59 pikë. (Amerikane, 2022).

PERFUNDIM DHE REKOMANDIMET

Kosova karakterizohet më një sistem tatimore mire të rregulluar, duke pasur dispozita ligjore të harmonizuara më legjislacionin e Bashkimit Evropian, Kosova konsiderohet si njeri nga vendet me normat më të ultë të tatimit mbi të ardhurat në Evropë, më një normë tatimore prej 10% e mbi të ardhurat personale si dhe më një normë fikse prej 10% e të ardhurave mbi korporatat, këto norma tatimore konsiderohet së ofrojnë një mjedis fitimprurës për investime. Sipas shumë studimeve ekonomike të realizuar mbi efektin që normat tatimore e kanë në biznese është konstatuar së normat e ultë tatimore janë një instrument i rëndësishëm për bizneset të cilët i shfrytëzojnë fitimin e realizuar për zhvillimin e biznesit të tyre.

Gjithashtu normat e ultë tatimore konsiderohet si përparësi e Kosovës në promovimin e kapaciteteve investuese, ku sa me të ultë normat tatimore aq më pak është pjesa e të hyrave të cilat bizneset i paguajnë shtetit, andaj edhe sipas Qendrës për politika tatimore në Amerikë, deklaron se duke pasur norma të ulëta të tatimit mbi të ardhurat, kompanitë do të tërhiqen më shumë për të investuar në Kosovë.

Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme kanë një kontribut të rëndësishëm në të hyrat publike të mbledhura nga sistemi tatimore ku të hyrat e realizuar nga Tatimit në Korporata si dhe të hyrat e mbledhura nga Bizneset individuale janë burime shumë të rëndësishme me rreth 27 % e të hyrave tatimore mbledhen nga këto dy kategori të bizneseve. Gjithashtu vlen të theksohet trendi pozitiv i regjistrimit të bizneseve në Kosovë, andaj është e nënkuptueshme së do të vazhdohet trendi pozitiv në rritjen e të hyrave tatimore nga NMV-të.

Rekomandimet të cilat dalin nga ky punimi kanë të bëjnë më sistemin tatimore

1. Rritja e shërbimeve elektronike- Në një ekonomi digjitale vazhdimi i përditësimit të sistemit E-deklarimi është një nevojë e vazhdueshme të cilët duhet ta kenë prioritet Administrata Tatimore e Kosovës;
2. Mbështetja Financiare për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme, në një situatë pas pandemisë është thelbësorë që të ofrohen paketa financiare për bizneset ekzistuese por dhe për mbështetjen e krijimit të bizneseve të reja, ku rritja përmes kësaj rritje do të gjenerohen dhe të hyra me të larta tatimore.

LITERATURA

1. ATK. (2022, Gusht 23). *Administrata Tatimore e Kosovës*. Retrieved from <https://www.atk-ks.org/#>
2. ATK. (2022). *Raporti i Punës Janar-Dhjetor*. Prishtinë: Administrata Tatimore e Kosovës.
3. ATK. (2021). *Raporti i Punës Janar-Dhjetor*. Prishtinë: Administrata Tatimore e Kosovës.
4. ATK. (2020). *Raporti i Punës Janar-Dhjetor*. Prishtinë: Administrata Tatimore e Kosovës.
5. ATK. (2019). *Raporti i Punës Janar-Dhjetor*. Prishtinë: Administrata Tatimore e Kosovës.
6. ATK. (2018). *Raporti i Punës Janar-Dhjetor*. Prishtinë: Administrata Tatimore e Kosovës.
7. ATK. (2017). *Raporti i Punës Janar-Dhjetor*. Prishtinë: Administrata Tatimore e Kosovës.
8. Bexheti, A. (2007). *Financat Publike*. Tetovë: Universiteti i Evropës Juglindore.
9. (n.d.). *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*.
10. Smith, A. (1776). *The wealth of Nations*.
11. Zeka, A. (2021). *Indeksi i Konkurrshmërisë së Prodhimit*. Prishtinë: Oda Ekonomike Amerikane
12. ARBK.(2021) Raporti I Indikatorëve bazë të performancës për regjistrimin e shoqërive tregtare në Kosovë
13. ARBK.(2020) Raporti I Indikatorëve bazë të performancës për regjistrimin e shoqërive tregtare në Kosovë
14. ARBK.(2019) Raporti I Indikatorëve bazë të performancës për regjistrimin e shoqërive tregtare në Kosovë
15. ARBK.(2018) Raporti I Indikatorëve bazë të performancës për regjistrimin e shoqërive tregtare në Kosovë
16. Urban Institute (2022) [How do taxes affect the economy in the long run? | Tax Policy Center](#)
17. Ligji Nr. 04/L-223 “Ligj për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 03/l-222 për administratën tatimore dhe procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/l-102”, me datën 13.01.2014
18. Ligjin nr. 05/L-37“ Për tatimin mbi vlerën e shtuar” me datën 01.09.2015,
19. Ligjin nr. 05/L-28 “ Për tatimin në të ardhura personale” me datën 01.09.2015,
20. Ligjin nr. 06/L-105 “ Për tatimin në të ardhura të korporatave” me datën 09.09.2019,